



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 898 Prot.,

Tiranë, më 2.10.2023

Urdhër

Nr. 74, datë 2.10.2023

“Për Inspektimin e rasteve të emërimit dhe largimit të nëpunësve në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Kavajë”

Në bazë të nenit 11, pika 1 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, I ndryshuar dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/Inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit, si edhe pas informacioneve të administruara nga Komisioneri; raportimeve të inspektorit të ngarkuar me ndjekjen e vazhdueshme të situatës së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kavajë, për raste të plotësimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e sistemit të shërbimit civil, duke mos respektuar procedurën e konkurrimit, si edhe për raste të largimeve të padrejta nga puna, lindin dyshime të arsyeshme për parregullsi në zbatimin e ligjit për nëpunësin civil në këtë institucion.

Për këtë arsye

URDHËROJ:

1. Nisjen e inspektimit për verifikimin e zbatimit të ligjit gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kavajë, me objekt:
 - Respektimi i procedurës dhe kërkesave të ligjit gjatë procesit të emërimeve në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, duke evidentuar rastet e emërimit në kundërshtim me ligjin;
 - Zbatimi i ligjit gjatë palikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, apo lirimit nga shërbimi civil, duke evidentuar të gjitha rastet e largimit apo lirimit të nëpunësve nga shërbimi civil.
2. Inspektimi do të kryhet në subjekt nga data 3.10.2023 deri në datën 6.10.2023, nga grupi i punës i përbërë nga Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes Altin Shumeli dhe inspektorët Alda Xhaxhiu, Francheska Dokasani dhe Dorela Halilaj.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha